



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës - Tužilački Savet Kosova - Kosovo Prosecutorial Council**

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në mbështetje të nenit 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.13 të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (G.Z. nr.10, datë 03 prill 2019), në mbledhjen e mbajtur më 14 janar 2020, miraton:

**— RREGULLORE NR. 01/2020**  
**PËR TRAJNIME DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL NË SISTEMIN**  
**PROKURORIAL**

**KAPITULLI I**  
**DISPOZITAT THEMELORE**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo rregullore vendos kriteret për përcaktimin e politikave, standardeve dhe udhëzimeve të trajnimit të prokurorëve dhe personelit tjetër, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të trajnimit dhe zhvillimit profesional të prokurorëve dhe personelit administrativ në sistemin prokurorial.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha nivelet e organizimit të Prokurorit të Shtetit dhe njësisve përkatëse të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

**Neni 3**  
**Përkufizimet dhe shkurtesat**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
  - 1.1 "KPK" - Këshilli Prokurorial i Kosovës;
  - 1.2 "KPSH" - Kryeprokurori i Shtetit;
  - 1.3 "ZKPSH" - Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;
  - 1.4 "PSRK" - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës;
  - 1.5 "SKPK" - Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës;
  - 1.6 "NJSHP" - Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive;

- 1.7 "Trajnim fillestar" - nënkupton trajnimin siç përcaktohet me Ligjin për Prokurorin e Shtetit, të cilit i nënshtrohen prokurorët e sapoemëruar;
- 1.8 "Trajnim i vazhdueshëm" - nënkupton trajnimin, të cilin e ndjekin prokurorët dhe personeli administrativ gjatë karrierës së tyre në kuadër të sistemit prokurorial, siç përcaktohet me këtë rregullore;
- 1.9 "Trajnim i detyrueshëm" - nënkupton trajnimin, i cili duhet të përmbushet nga prokurori sipas kërkesës së KPK-së apo kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse;
- 1.10 "Programet e tjera të arsimit ligjor" - nënkuptojnë programet trajnuese apo akademike, në të cilat merr pjesë prokurori me miratimin, siç përcaktohet me këtë rregullore.
- 1.11 "Akademia" - nënkupton Akademinë e Drejtësisë.

#### **Neni 4**

##### **Qëllimi i zhvillimit profesional**

Zhvillimi profesional nënkupton trajnimet dhe programet e tjera të arsimit ligjor apo studimit, të cilat ofrohen për prokurorët e shtetit dhe personelin administrativ të sistemit prokurorial, me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së aftësive, shkathësive dhe njohurive të tyre, që lidhen detyrat dhe përgjegjësit e vendit të punës.

#### **Neni 5**

##### **Njësia përgjegjëse për zhvillim profesional**

1. Njësia për Zhvillim Profesional në kuadër të NJSHP-së është përgjegjëse për mbështetjen e procesit të zhvillimit profesional brenda sistemit prokurorial.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë përgjegjëse për Zhvillim Profesional në kuadër të NJSHP-së përcaktohen me Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e NJSHP-së.

#### **Neni 6**

##### **Format e zhvillimit profesional**

1. Format kryesore të zhvillimit profesional, me qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje janë:
  - 1.1 Trajnimi fillestar, i vazhdueshëm, vullnetar apo i detyrueshëm;
  - 1.2 Programet e ndryshme të shkëmbimit të njohurive dhe përvojave në fushën ligjore dhe fusha me interes për sistemin prokurorial;
  - 1.3 Seminaret dhe punëtoritë e ndryshme për zhvillim të kapaciteteve menaxhuese, profesionale dhe ndërdisiplinore;

- 1.4 Programet e arsimit ligjor dhe studimit shkencor apo hulumtues që lidhen me vendin e punës;
- 1.5 Simulimet e gjykimeve;
- 1.6 Mësimi nga distanca (E-Learning);
- 1.7 Vizitat studimore në institucione apo organizata që lidhen me vendin e punës.

## **KAPITULLI II ZHVILLIMI PROFESIONAL I PROKURORIT TË SHËTETIT**

### **Neni 7 Trajnimi fillestar**

1. Prokurorët e sapoemëruar, me përjashtim të atyre që kanë përvojë paraprake si prokurorë, duhet të marrin pjesë në trajnimin fillestar, të organizuar nga Akademia në pajtim me Ligjin për Prokurorin e Shtetit, Ligjin për Akademinë e Drejtësisë dhe legjislacionin tjetër përkatës në fuqi.
2. Mënyra e organizimit të trajnimit fillestar, përmbajtja, struktura, kohëzgjatja dhe mbarëvajtja e tij rregullohet me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, përkatësisht, aktet nënligjore të miratuara nga Akademia.
3. KPK-ja dërgon listën e prokurorëve pjesëmarrës dhe kërkesën për fillimin e trajnimit fillestar në Akademi, pa vonesë pas dekretimit të prokurorëve të rinj.
4. Prokurorët e caktuar si mentorë duhet t'i angazhojnë prokurorët në trajnim fillestar që trajnimin praktik ta realizojnë përmes rasteve reale në punë.

### **Neni 8 Obligimet e prokurorëve në trajnimin fillestar**

1. Prokurorët pjesëmarrës në trajnimin fillestar janë të detyruar që:
  - 1.1 Të marrin pjesë dhe ta përfundojnë me sukses trajnimin teorik dhe praktik (monitorimi), siç përcaktohet nga Akademia;
  - 1.2 T'i nënshtrohen programeve të vlerësimit nga Akademia;
  - 1.3 Të respektojnë dhe zbatojnë të gjitha rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga Akademia për organizimin e trajnimit fillestar.
2. Pas përfundimit me sukses të trajnimit fillestar, prokurorët janë të detyruar që të fillojnë trajtimin e rasteve sipas procedurës së përcaktuar për këtë qëllim.

## **Neni 9**

### **Vijueshmëria dhe pushimet**

1. Trajnimi fillestar duhet të vijohet sipas programit dhe kalendarit të Akademisë.
2. Për Prokurorin e Shtetit që nuk fillon apo ndërpre në trajnimin në rrethanat e arsyeshme, KPK-ja do t'i drejtohet me kërkesë Akademisë që t'i mundësojë ndjekjen e trajnimit me gjeneratën e radhës të prokurorëve apo në rastin e parë të mundshëm që organizohet ky program nga Akademia.
3. Prokurorët në trajnim fillestar kanë të drejtë në pushim vjetor siç përcaktohet me ligj, dhe caktohet si pushim kolektiv nga Akademia në koordinim me Këshillin, me të cilin njoftohet kryeprokurori i prokurorisë përkatëse.

## **Neni 10**

### **Vlerësimi i prokurorëve gjatë dhe pas trajnimit**

1. Vlerësimi i prokurorëve gjatë trajnimit bëhet nga trajnuesit dhe mentorët, ndërsa pas trajnimit nga komisionet përkatëse të KPK-së dhe vlerësimi përfundimtar miratohet nga KPK-ja në përputhje me Rregulloren për vlerësimin e performancës së prokurorëve.
2. Vlerësimi pas trajnimit bëhet në bazë të rezultateve të prokurorëve të treguara gjatë trajnimit fillestar, të cilat janë nxjerrë nga raporti përfundimtar dhe shkresat përcjellëse, të mbajtura nga Akademia gjatë trajnimit, në bazë të të cilave do të vendoset për përfundimin në mënyrë adekuate të trajnimit fillestar nga ana e prokurorëve të sapoemëruar.

## **Neni 11**

### **Përfundimi me sukses i trajnimit**

1. Pas përfundimit të trajnimit fillestar, prokurorët do t'i nënshtrohen vlerësimit në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi, dhe në bazë të rezultateve të treguara gjatë trajnimit fillestar në Akademi.
2. Për t'u konsideruar se një prokuror e ka përfunduar trajnimin në mënyrë adekuate, gjatë vlerësimit duhet të merren për bazë kriteret e përcaktuara nga Akademia për përfundimin e trajnimit me sukses dhe kriteret e përcaktuara në Rregulloren e KPK-së për vlerësimin e performancës së prokurorëve.

## **Neni 12**

### **Trajnimi shtesë**

1. Nëse Komisioni për vlerësimin e performancës së prokurorëve, nga rezultatet e trajnimit fillestar vlerëson se prokurori nuk ka përmbushur në mënyrë adekuate trajnimin, KPK-ja mund t'i bëjë kërkesë të specifikuar Akademisë për të organizuar trajnime shtesë për atë prokurorë.

2. Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna të detajuara lidhur me prokurorin, kohëzgjatjen, si dhe për përmbajtjen e trajnimit shtesë që do të organizohet.
3. Pas përfundimit të trajnimit shtesë, Akademia njofton KPK-në për rezultatet e trajnimit të prokurorit përkatës, ndërsa vlerësimi i prokurorit do të bëhet njëjtë sikur në fazën e parë të vlerësimit.

### **Neni 13** **Trajnimi i vazhdueshëm**

1. Trajnimi i vazhdueshëm mund të organizohet si:
  - 1.1 Trajnim i detyrueshëm dhe
  - 1.2 Trajnimi vullnetar.

### **Neni 14** **Trajnimi i vazhdueshëm i detyrueshëm**

1. Në parim trajnimi i prokurorëve është vullnetar, megjithatë, gjatë një viti kalendarik të gjithë prokurorët duhet të marrin pjesë së paku në tri (3) sesione trajnuese.
2. Prokurorët i nënshtrohen trajnimit të detyrueshëm me kërkesë të KPK-së apo Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse, varësisht nga performanca e tyre në punë apo ndryshimeve në legjislacion.
3. Kërkesa për trajnimin e detyrueshëm përmban temat dhe numrin e ditëve të trajnimit.

### **Neni 15** **Rastet e përcaktimit të trajnimeve të detyrueshme**

1. KPK-ja dhe kryeprokurori i prokurorisë përkatëse mund të kërkojnë nga prokurorët të marrin pjesë në trajnime, të cilat konsiderohen detyrueshme në këto raste:
  - 1.1 Në bazë të vlerësimit të performancës së prokurorëve nëse konsiderohet se një prokurorë ka nevojë për trajnime në fusha specifike;
  - 1.2 Kur ka ndryshime legjislative;
  - 1.3 Kur prokurori avancohet nga një departament në tjetrin apo kur kalon në pozitë menaxhuese dhe
  - 1.4 Për ngritjen e nivelit të integritetit\etikës profesionale në sistemin prokurorial.
2. Trajnimet nga pikat 1.1 dhe 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni janë kërkesa individuale për trajnim të detyrueshëm, të cilat iu drejtohen prokurorëve të caktuar, ndërsa trajnimet nga pikat 1.2 dhe 1.4 të paragrafit 1 të këtij neni janë kërkesa grupore apo të përgjithshme, të cilat iu drejtohen të gjithë prokurorëve apo grupeve të caktuara të prokurorëve.

3. KPK-ja do të njoftojë me kohë prokurorët dhe Akademinë për programin e detyrueshëm të trajnimeve, në mënyrë që të mund të përgatiten trajnimet dhe të mundësohet pjesëmarrja e secilit prokuror.

#### Neni 16

##### Detyrimi për të marrë pjesë në trajnim

1. Të gjithë prokurorët duhet të përmbushin detyrimet e tyre për trajnimet brenda një viti kalendarik në pajtim me këtë rregullore.
2. Të liruar nga trajnimi i detyrueshëm siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni janë:
  - 2.1 Kryeprokurori i Shtetit;
  - 2.2 Kryesuesi dhe Zëvendëskryesuesi i KPK-së;
  - 2.3 Kryetarët e komisioneve të përhershme të KPK-së me orar të plotë dhe
  - 2.4 Prokurorët që janë duke ndjekur programe të shkollimit akademik jashtë vendit.

#### Neni 17

##### Kërkesa për lirim nga detyrimi i trajnimit

1. Prokurorët mund të kërkojnë të lirohen nga detyrimi për pjesëmarrje në trajnime të detyrueshme, duke parashtruar edhe arsyet që pamundësojnë pjesëmarrjen në trajnim.
2. Kërkesa për lirim nga detyrimi për të marrë pjesë në trajnim, e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, i drejtohet kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse, i cili merr vendim lidhur me kërkesën.
3. Në rast se kryeprokurori i një prokurorie kërkon që të lirohet nga detyrimi për të marrë pjesë në trajnim të detyrueshëm ia parashtron kërkesën Kryesuesit të KPK-së.
4. Rastet të cilat mund të lirohet prokurori nga detyrimi për të marrë pjesë në trajnim janë kur prokurori:
  - 4.1. Është në pushim të miratuar sipas legjislacionit në fuqi në kohën kur është caktuar për të marrë pjesë në trajnim dhe dukshëm është e qartë se nuk mund të marrë pjesë në të njëjtin trajnim në periudha të mëvonshme gjatë atij viti.
  - 4.2. Është në studime jashtë vendit apo programe të tjera arsimimi/trajnimi në kohëzgjatje më shumë se gjashtë (6) muaj.
  - 4.3. Është trajnues në trajnimin e caktuar për të marrë pjesë;
  - 4.4. Trajnimin e njëjtë tashmë e ka ndjekur vullnetarisht;

- 4.5. Ka ndërruar profil të punës dhe trajnimi tashmë i rekomanduar për t'u ndjekur nuk është relevant, dhe
- 4.6. Në çdo rast kur dëshmohet irelevanca e trajnimit.
5. Kryesuesi i KPK-së njofton Kryeprokurorin, përkatësisht Kryeprokurori njofton prokurorin me vendim dhe i njëjti i dërgohet Njesisë përgjegjëse për trajnime brenda 30 ditëve të punës dhe i bashkëngjitet dosjes së prokurorëve.

#### **Neni 18**

##### **Mospërmbushja e trajnimit të vazhdueshëm të detyrueshëm**

Mospërmbushja e detyrimeve të prokurorit që dalin nga kjo rregullore trajtohet në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për përgjegjësinë disiplinore dhe Kodin e etikës dhe sjelljes profesionale për prokurorë.

#### **Neni 19**

##### **Trajnimi i vazhdueshëm vullnetar**

1. Përveç trajnimeve të detyrueshme, prokurorët janë të lirë të zgjedhin trajnimet, në të cilat do të marrin pjesë, në konsultim me kryeprokurorin e prokurorisë dhe në pajtim me këtë rregullore, me qëllim të ngritjes së aftësive profesionale dhe shkathtësive praktike.
2. Pjesëmarrja në trajnime vullnetare bëhet në pajtim me Udhëzimin e Kryeprokurorit të Shtetit.

#### **Neni 20**

##### **Përmbajtja e trajnimeve**

Programet e trajnimit, në të cilat prokurorët mund të marrin pjesë sipas vullnetit të tyre të lirë duhet të jenë të lidhura ngushtë me punën e tyre dhe të kenë ndikim në ngritjen e kapaciteteve profesionale të tyre dhe performancën e përgjithshme individuale dhe të prokurorisë.

#### **Neni 21**

##### **Anulimi i njëanshëm i pjesëmarrjes në trajnim**

1. Prokurori që aplikon për të marrë pjesë në trajnim apo konfirmon pjesëmarrjen në trajnim nuk mund ta anulojë pjesëmarrjen pa arsye të argumentuara, në të kundërtën, mund t'i nënshtrohet procedurave disiplinore.
2. Për anulimin e pjesëmarrjes në trajnim dhe arsyet për anulim, prokurori duhet ta njoftojë kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse në afatën sa më të shpejtë të mundshëm.

#### **Neni 22**

##### **Organizatorët e trajnimeve**

1. Prokurorët duhet të marrin pjesë në trajnimet e organizuara nga Akademia e Drejtësisë.

2. Trajnimi për prokurorë mund të organizohet edhe nga institucionet e tjera me kredibilitet të lartë, që kanë përvojë të konsiderueshme në ofrimin e trajnimeve përkatëse, si dhe organizata të huaja që organizojnë trajnime brenda dhe jashtë vendit, në mënyrë që programi i trajnimit dhe pjesëmarrja në trajnime të tilla të jetë në pajtim me këtë rregullore.

#### **Neni 23**

#### **Profilizimi i prokurorëve dhe trajnimi**

KPK-ja do të miratojë politika për profilizimin e prokurorëve dhe do të nxisë prokurorët që të marrin pjesë në trajnime sipas profilit të ngushtë profesional, varësisht nga funksioni që ushtrojnë në praktikë.

#### **Neni 24**

#### **Vlerësimi i nevojave për trajnimin e prokurorëve**

1. Kryeprokurorët dhe Njësia përgjegjëse për trajnime në kuadër të NJSHPP-së zhvillojnë procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime dhe duhet t'i dorëzojnë KPK-së më së largu deri në tetor të çdo viti kalendarik një plan të detajuar për nevojat individuale për trajnim të prokurorëve dhe nevojat për trajnime të përgjithshme.
2. KPK-ja pas shqyrtimit të këtij plani miraton politikat dhe kërkesat për trajnime për Akademinë dhe i njofton prokurorët për trajnimet e detyrueshme, të cilat organizohen gjatë vitit vijues.

### **KAPITULLI III**

### **ZHVILLIMI PROFESIONAL I PERSONELIT TË ADMINISTRATËS SË SISTEMIT PROKURORIAL**

#### **Neni 25**

#### **Trajnimet për personelin e administratës së sistemit prokurorial**

Personeli i administratës së sistemit prokurorial ka të drejtë dhe detyrim të marrin pjesë në programet e trajnimit për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe shkathhtësive praktike në funksion të realizimit të detyrave të punës.

#### **Neni 26**

#### **Pjesëmarrja në trajnime**

1. Personeli i administratës merr pjesë në trajnim me kërkesë të mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre dhe me kërkesën e personelit pas miratimit të saj nga mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë.
2. Administratorët e prokurorive në konsultim me kryeprokurorët e prokurorive përkatëse dhe Drejtorin e Përgjithshëm të SKPK-së përgatisin listat e pjesëmarrësve për trajnimin e personelit të prokurorive.

3. Udhëheqësit e departamenteve në administratën e SKPK-së dhe NJSHPP-së në konsultim me Drejtorin e Përgjithshëm të SKPK-së përgatisin listat e pjesëmarrësve në trajnime të personelit të prokurorive të administratës së KPK-së.

#### Neni 27

#### Vlerësimi i nevojave për trajnime të personelit administrativ

1. Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Drejtori i NJSHPP-së dhe administratorët e prokurorive zhvillojnë procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime dhe duhet t'i dorëzojnë KPK-së më së largu deri në tetor të çdo viti kalendarik një plan të detajuar për nevojat individuale për trajnim të personelit administrativ dhe nevojat për trajnime të përgjithshme.
2. KPK-ja pas shqyrtimit të këtij plani të trajnimeve miraton politikat dhe kërkesat, për të cilat njofton stafin administrativ për trajnimet që do të organizohen gjatë vitit vijues.

### KAPITULLI IV PROGRAMET E SHKËMBIMIT

#### Neni 28

#### Qëllimi i programit të shkëmbimit

1. Programet e shkëmbimit janë formë e veçantë e zhvillimit profesional që u mundëson pjesëmarrësve të marrin informacion të drejtpërdrejtë, të fitojnë njohuri dhe shkathtësi praktike dhe të shkëmbejnë pikëpamjet dhe përvojat me institucione të ndryshme në juridiksione të vendeve të huaja, si dhe të mësojnë nga praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare.
2. Programet e shkëmbimit kanë qëllim që të përmirësojnë punën profesionale dhe aftësitë e prokurorëve dhe stafit administrativ, të cilat kanë ndikim në përmirësimin e proceseve të punës në administrimin e drejtësisë dhe reformat në institucionet e sistemit prokurorial në Kosovë.

#### Neni 29

#### Llojet e programeve të shkëmbimit

1. Llojet e programeve të trajnimit jashtë vendit janë:
  - 1.1 Programe afatshkurtra që zgjatin deri në një javë;
  - 1.2 Programet afatmesme që zgjatin më shumë se një javë dhe deri në një muaj dhe
  - 1.3 Programe afatgjata që zgjatin më shumë se një muaj.

**Neni 30**  
**Programet e shkëmbimit të organizuara për zyrtarët e huaj**

Sistemi prokurorial i Kosovës sipas kërkesës dhe në varësi të mundësive buxhetore mund të organizojë programe të shkëmbimit për prokurorë dhe staf administrativ të huaj, të përshtatshme me nevojat dhe kërkesat specifike të secilit grup të synuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 31**  
**Kriteret për përzgjedhjen e pjesëmarrësve**

1. Përzgjedhja dhe pjesëmarrja në programet e shkëmbimit do të varet nga lloji, kohëzgjatja dhe objektivat e programit, si dhe do të bazohet kryesisht në kriteret objektive, transparente dhe në bazë të meritave, e cila do të mundësojë qasje të barabartë.
2. Kriteret për përzgjedhje dhe pjesëmarrje do të përcaktohen në varësi të rrethanave dhe kërkesave në secilin rast të veçantë, duke marrë parasysh kriteret minimale të paraqitura më poshtë:
  - 2.1. Për programet e shkëmbimit për prokurorë, pjesëmarrësi duhet të jetë prokurorë;
  - 2.2. Për programet e shkëmbimit për staf administrativ, pjesëmarrësit duhet të jenë staf administrativ i sistemit prokurorial;
  - 2.3. Për programet e shkëmbimit për menaxhim, pjesëmarrësit duhet të jenë prokurorë apo staf administrativ në pozita menaxhuese;
  - 2.4. Pjesëmarrësit duhet të kenë vlerësim pozitiv në punë dhe të mos kenë masa disiplinore të shqiptuara në kohën e realizimit të programit të shkëmbimit;
  - 2.5. Pjesëmarrësit prokurorë të jenë me mandat të përhershëm, kurse ata të stafit administrativ të kenë kaluar periudhën provuese;
  - 2.6. Pjesëmarrësit të mos kenë qenë pjesëmarrës më parë në programin e njëjtë apo në programe të ngjashme të shkëmbimit.
3. Përzgjedhja e pjesëmarrësve të duhur duhet gjithmonë të bazohet në vlerësimin rast pas rasti të nevojave konkrete për trajnim, fushën personale të ekspertizës profesionale, prioritetet ekzistuese në sistemin prokurorial, motivimin dhe aftësinë për të zbatuar njohuritë e fituara dhe kriteret e tjera të përcaktuara me këtë rregullore.

**Neni 32**  
**Procedurat e përzgjedhjes**

1. Të gjithë prokurorët dhe stafi administrativ të interesuar apo të propozuar nga organizatori për të marrë pjesë në programet e shkëmbimit duhet të bëjnë kërkesë për të marrë pjesë në program të shkëmbimit të autoritetet përkatëse, siç është përcaktuar në këtë rregullore.

2. Varësisht nga programi, KPK-ja mund të bëjë thirrje të hapur për aplikime për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në programet e shkëmbimit apo studimit jashtë vendit.

#### Neni 33

##### Vlerësimi dhe kërkesat pas programit

1. Çdo pjesëmarrësi që merr pjesë në një program të shkëmbimit jashtë vendit do t'i kërkohej të vlerësojë programin dhe të përgatisë një raport mbi mënyrën se si ai/ajo do të përdorë më së miri mësimet e nxjerra dhe përvojën e fituar.
2. Varësisht nga programi, pjesëmarrësve mund t'iu kërkohej të përfshihen në aktivitete, të cilat do të mundësojnë bartjen e njohurive, duke aplikuar praktikat dhe standardet më të mira të fituara nga programi.

#### Neni 34

##### Financimi i programeve të shkëmbimit

Për të gjitha programet e shkëmbimit, të miratuara siç përcaktohet me këtë rregullore, shpenzimet për pjesëmarrje do të mbulohen nga buxheti i sistemit prokurorial nëse ato nuk mbulohen nga organizatori apo donatori.

#### Neni 35

##### Programet e vizitave studimore dhe të përfaqësimit

1. Në funksion të përfaqësimit dhe zhvillimit institucional organizohen programet e vizitave studimore, takimet përfaqësuese dhe pjesëmarrja në konferenca të karakterit rajonal dhe më gjerë jashtë Kosovës.
2. Përgjegjës për caktimin e pjesëmarrësve prokurorë në këto aktivitete janë Kryesuesi i KPK-së, Kryeprokurori i Shtetit dhe Drejtori i SKPK-së për stafin administrativ, varësisht nga përmbajtja e programit të aktivitetit të caktuar dhe niveli i organizimit dhe përfaqësimit.

#### Neni 36

##### Mbajtja dhe përpunimi i të dhënave lidhur me trajnimet e prokurorëve

1. Kryeprokurorin përkatës e informon me shkrim Njësia përgjegjëse për trajnime për pjesëmarrjen në trajnime të prokurorëve të prokurorisë që udhëheq, përmbajtjen e trajnimeve dhe kohëzgjatjen e trajnimit, përfshirë edhe vendimet për miratim ose refuzim të pjesëmarrjes në trajnim.
2. Njësia përgjegjëse për trajnime i vendos në dosjen personale të prokurorëve të gjitha të dhënat e pranuar nga kryeprokurori dhe përgatit raporte të rregullta dhe sipas kërkesave për KPK-në dhe komisionet e tij.

#### Neni 37

##### Mbajtja dhe përpunimi i të dhënave lidhur me trajnimet e personelit administrativ

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në kuadër të SKPK-së në bashkëpunim me të gjitha njësitë administrative mban të dhëna për pjesëmarrjen në trajnime të personelit të administratës së sistemit prokurorial, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimeve, si dhe përgatit raporte të rregullta dhe sipas kërkesave për trajnimet e personelit të administratës.

#### **Neni 38**

#### **Mbajtja dhe përpunimi i të dhënave lidhur me programet e shkëmbimit**

Njësia përgjegjëse për trajnime mban të dhëna për planifikimin, organizimin dhe pjesëmarrësit në programet e shkëmbimit, monitoron e vlerëson efektin e kësaj forme të veçantë të trajnimit, si dhe për aktivitetet pas programit, në të cilat janë angazhuar pjesëmarrësit e programit të shkëmbimit.

#### **Neni 39**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, më 14 janar 2020

Bahri Hyseni

Kryesues

Këshilli Prokurorial i Kosovës

